

Në fillim të muajit nëntor ka hyrë në fuqi ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ndoshta të gjithë kishim një ndjenjë mosbesimi për atë çfarë te re, do të sillte ky ligj në raport me ligjin që kishte vepruar deri në atë kohe, me transparencën, procedurën e deri tek sanksionet.

Sot, në vijim edhe të konferencës kombëtare për të drejtën për informim të mbajtur në dhjetor të vitit të kaluar, megjithëse koha është e shkurtër, kemi një bilanc për të bërë. Dhe vet kjo është diçka pozitive, ashtu si edhe në veprimtarinë e autoriteteve publike ka vlerësim, por nga ana tjetër edhe probleme e mospërbushje të detyrimeve të ligjit.

Ne konferencën e muajit dhjetor ne prezantuam projekt programin e transparencës për autoritetet publike dhe të gjithë projekt aktet e tjera.

Deri në mes të janarit 2015, pritem sugjerimet e të gjithë palëve të interesuara në këtë proces.

Në vijim, me urdhrin nr. 14, datë 22.01.2015 “Për miratimin e programit model të transparencës”, të Komisionerit, botuar edhe ne fletoren zyrtare nr. 6 date 28.01.2015, gjeni programin model të transparencës, rregjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve, modelet e vendimmarrjes, formatin e ankesës pranë KDIMDP, etj.

Konstatoj se nga ana e autoriteteve publike nuk është bere aq sa duhet për zbatimin e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ligji përcakton detyrime për titullarët / koordinatorët / nëpunësit që janë përgjegjës direkt për mosdhënien e informacionit.

Gjatë veprimtarisë tone kemi konstatuar se një pjesë e mirë, nuk kishin dijeni për ligjin e ri, nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre, ashtu si edhe caktimi i koordinatorëve është kryer në shumicën e rasteve pas ndërhyrjes tone.

Deri me tani, nuk kemi vendosur sanksione administrative edhe pse ligji na detyron, por ne jemi nisur nga parimi se qëllimi i ligjit nuk është vendosja e sanksionit, por zbatimi i tij.

Deri më sot kjo është mbajtur si përgjegjësi nga Komisioneri, por nga nesër do ta ndajmë së bashku.

Që prej hyrjes në fuqi të ligjit, përveç punës sensibilizuese dhe përgatitjes së dokumenteve standarte, nga ana e Zyrës së Komisionerit, me gjithë mungesën e strukturës përgjegjëse dhe eksperiencës, janë trajtuar gjithsej 64 ankesa, janë kryer 14 inspektime ne vend dhe janë marre 21 vendime.

Një punë jo e vogël, që jo pak here është ndeshur edhe me mentalitetin e vjetër të një pjese të administratës sonë publike, ku çdo gjë zyrtare nuk mund të jetë transparente.

Autoritetet Publike kane edhe një muaj kohe për Programet e Transparencës, që nuk është gjë tjetër përveçse informacioni që bëhet publik pa kërkesë, pra transparenca e institucionit.

Megjithatë në punën tonë, ne kemi gjetur partnerë publikun e gjerë që me ankesat e tyre tregojnë besimin në këtë institucion të ri, në grupimet e shoqërisë civile, median, etj.

E për këtë me duhet të vlerësoj një partner të rëndësishëm, mbështetjen dhe kontributin e tij, Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, dhe për këtë arsye ja kaloj fjalën Drejtorit Ekzekutiv, zotit Dobrusha për përshëndetjen e tij.

Ju faleminderit dhe uroj punë të mbarë këtij takimi.